



MODELI 3D I QYTETIT TË KUKËSIT
PËRFTUAR NGA TEKNOLOGJIA UAV

Rilevim me teknologjinë UAV - Qyteti i Kukësit dhe i Elbasanit

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), ASIG vijon mbështetjen e procesit të Regjistrimit Fillestar përmes realizimit dhe përpunimit të ortofotove të reja me teknologjinë UAV.

Deri në këtë fazë, janë realizuar dhe përgatitur ortofotot për qytetet e Kukësit dhe Elbasanit, përkatësisht me sipërfaqe 9.1 km² dhe 7.9 km², ndërsa zonat e tjera janë në proces fotografimi dhe përpunimi.

Përdorimi i këtyre ortofotove kontribuon në identifikimin më të saktë të objekteve dhe parcelave, në përmirësimin e cilësisë së verifikimeve në terren, si dhe në rritjen e saktësisë së produkteve përfundimtare në kuadër të procesit të Regjistrimit Fillestar.

Kjo nismë mbështet proceset e administrimit të territorit përmes përdorimit të teknologjive moderne dhe të dhënave gjeohapësinore me cilësi dhe saktësi të lartë.



Ortofoto - Kukës



Ortofoto - Elbasan


Publikime në Gjeoportalin Kombëtar

Publikohet informacion gjeohapësinor për temën “Njësitë Statistikore”

ASIG në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT), si autoritet publik përgjegjës për temën "Njësitë Statistikore", ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresat:

- “Grid 1 km² Census (INSTAT)”;
- “Ndërtesa Census (INSTAT)”;
- “Njësitë e Qeverisjes Vendore Census (INSTAT)”.

Të dhënat e Census-it 2023 paraqesin shpërndarjen e popullsisë në Republikën e Shqipërisë në nivel grid-i 1 km², informacionin për ndërtesat për qëllime banimi, si dhe shpërndarjen e popullsisë sipas njësive të qeverisjes vendore. Këto të dhëna janë përgjithësisht me vlefshmëri 10-vjeçare. Informacioni i publikuar është konform standardit shtetëror për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri të miratuar me VKM-në nr. 999, datë 09.12.2020, për temën “Njësitë Statistikore”.




Publikohet informacion gjeohapësinor për temën “Zonat e Mbrojtura”

ASIG në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), si autoritet publik përgjegjës për temën "Zonat e mbrojtura", ka përditësuar në Gjeoportalin Kombëtar informacionin gjeohapësinor për shtresat:

- “Zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore (Pikë)”;
- “Zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore (Poligon)”.

Këto të dhëna përfshijnë qendrat historike, zonat e tyre të mbrojtura dhe zonat arkeologjike të ndara sipas kategorive "A" dhe "B", të bazuara në intensitetin e pranisë së gjurmëve arkeologjike dhe zonat e mbrojtura të monumenteve të veçanta. Informacioni gjeohapësinor i publikuar është konform standardit shtetëror për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri, të miratuar me VKM-në nr. 891, datë 18.11.2020, për temën “Zonat e mbrojtura”.


Publikohet informacion gjeohapësinor për temën “Mbulesa e Tokës”



ASIG në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP), ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresat e temës "Mbulesa e tokës", si më poshtë:

- “Kufiri i ekonomisë pyjore”;
- “Parcela pyjore”;
- “Nënparcela pyjore”.

Të dhënat për këto shtresa bazohen në informacionin e gjeneruar nga Sistemi Shqiptar i Informacionit për Pyjet (ALFIS) i ngritur në kuadër të Projektit të Shërbimeve Mjedisore. Informacioni gjeohapësinor i publikuar është realizuar përmes digjitalizimit dhe regjistrimit të pyjeve dhe kullotave në vitet 2018–2020 në sistemin ALFIS, në kuadër të këtij projekti. Ky informacion është në përputhje me specifikimet teknike të standardit shtetëror të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri, të miratuar me VKM nr. 809, datë 21.10.2020.



Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar

Me qëllim krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara të akseve rrugore kombëtare, ASIG ka përdorur teknologjinë e avancuar me kamera Street View 360° për të realizuar dhe publikuar në Gjeoportalin Kombëtar si më poshtë:

- rrugët urbane të qytetit të Elbasanit dhe Aksin Sh3 (Qafa e Kërrabës) - 168 km;
- rrugët urbane të qytetit të Koplikut - 100.5 km;
- rrugët urbane të qytetit të Gramshit dhe Aksin Sh71 - 62 km;
- rrugët urbane të qytetit të Kukësit - 52 km.

Ky informacion vizual i detajuar shërben si mjet mbështetës për planifikimin territorial, menaxhimin e infrastrukturës dhe monitorimin e zhvillimeve urbane.



Rrugë Urbane - Elbasan



Rrugë Urbane - Koplik



Rrugë Urbane - Gramsh




Rrugë Urbane - Kukës

Zgjerimi i Hartës Bazë: Qyteti Rubik

ASIG, në cilësinë e autoritetit publik përgjegjës për temën "Harta Bazë", si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale për qytetin e Rubikut. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rievimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rievuar prej 2.4 km².

Numri i shtresave të përdorura për këto rievime fotogrametrike 3D arrin në 180 shtresa. Përpunimi i të dhënave, strukturimi i gjeodatabazës, kontrolli i saktësisë pozicionale, si dhe verifikimi në terren i elementeve të paqartë hartografikë, janë realizuar sipas manualeve përkatëse për krijimin e hartave topografike digjitale.




Qyteti Rubik

ASIG prezanton Monitorimin Interaktiv të Pyjeve në Zonat e Mbrojtura

Në kuadër të procesit të digjitalizimit të të dhënave gjeohapësinore, si dhe të përmirësimit të monitorimit dhe analizës së informacionit mjedisor, ASIG ka zhvilluar një *dashboard* interaktiv për paraqitjen dhe analizën e shpërndarjes së pyjeve në zonat e mbrojtura të Republikës së Shqipërisë.

Përmes hartës interaktive, statistikave dhe grafikëve dinamikë, institucionet publike mund të eksplorojnë sipërfaqet pyjore sipas zonave të mbrojtura dhe bashkive përkatëse, si dhe të përdorin filtra për të marrë informacion më të detajuar mbi gjendjen dhe shtrirjen e pyjeve. Ky aplikacion shërben si mjet mbështetës për monitorimin mjedisor, analizën territoriale dhe proceset e vendimmarrjes për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore.



Dashbord-i Interaktiv: "Monitorimi i Pyjeve në Zonat e Mbrojtura"

PJESËMARRJE NË AKTIVITETE

ASIG merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të EuroGeographics 2026

Përfaqësues të ASIG morën pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të EuroGeographics, të zhvilluar më 17–20 maj 2026 në Ostend, të Belgjikës. Aktiviteti mbledhi autoritete kombëtare të hartografisë, kadastrës dhe regjistrimit të tokës nga 42 shtete evropiane, me fokus rolin strategjik të të dhënave gjeohapësinore, të cilat janë thelbësore për sistemet dinamike në mbështetje të vendimmarrjes dhe për sigurimin e gatishmërisë, qëndrueshmërisë dhe reagimit evropian ndaj krizave.

Qëllimi kryesor i pjesëmarrjes në këtë aktivitet ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira, me synimin për të sjellë në ASIG modele dhe qasje që kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të institucionit.

Në kuadër të këtij takimi, pjesëmarrësit patën mundësinë të zhvillojnë diskutime dhe të forcojnë bashkëpunimin me organizatat simotra evropiane, si dhe të krijojnë lidhje me aktorë kyç të fushës së informacionit gjeohapësinor. Asambleja e Përgjithshme shërbeu gjithashtu si një platformë e rëndësishme për ndjekjen e prezantimeve nga folës dhe ekspertë të njohur ndërkombëtarë, të cilët trajtuan një gamë të gjerë temash që lidhen me informacionin gjeohapësinor.



TRAJNIME PËR GJEONFORMACIONIN

Me qëllim rritjen e kapaciteteve në menaxhimin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor, gjatë muajit maj 2026, ASIG organizoi trajnime të dedikuara për stafet teknike të institucioneve të mëposhtme:

- Shoqërisë Ujësjetllës–Kanalizime Tiranë, më 12 maj 2026;
- Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës–Kanalizime Berat, më 26 maj 2026.

Aktivitetet u fokusuan në mbledhjen, strukturimin dhe publikimin e të dhënave që lidhen me rrjetin e ujësjetllës–kanalizimeve, si dhe në përmirësimin e proceseve të administrimit të tyre sipas standardeve kombëtare të gjeoinformacionit.

Gjatë trajnimeve, pjesëmarrësit u njohën me kërkesat e standardit teknik të gjeoinformacionit “Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare”, si dhe me procedurat për përdorimin e Gjeoportalit Kombëtar për administrimin, përditësimin dhe shpërndarjen e të dhënave gjeohapësinore.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Sateliti Sentinel-1D nis operimin e plotë në kuadër të misionit radar të Copernicus

Sateliti Copernicus Sentinel-1D është tashmë plotësisht operacional, pas përfundimit me sukses të fazës kritike të komisionimit në orbitë. Ky zhvillim shënon një moment të rëndësishëm për misionin radar Sentinel-1, i cili ofron imazhe me rezolucion të lartë të sipërfaqes së Tokës, pavarësisht kushteve atmosferike dhe në çdo kohë të ditës apo natës. Të dhënat e këtij misioni janë thelbësore për monitorimin e fatkeqësive natyrore, akullit detar, deformimeve të tokës dhe shpyllëzimit, si dhe për mbështetjen e vendimmarrjes nga studiuesit, institucionet publike dhe strukturat e emergjencave.

Copernicus Marine integron inteligjencën artificiale në produktet e reja operationale detare

Shërbimi Copernicus Marine po integron inteligjencën artificiale (AI) në një brez të ri produktesh për parashikimin dhe monitorimin e oqeanëve, duke kombinuar modelet fizike me teknikat e *machine learning* dhe *deep learning*. Këto zhvillime synojnë përmirësimin e saktësisë së parashikimeve për akullin detar, erërat, valët dhe temperaturën e sipërfaqes së detit, përmes korrigjimit automatik të gabimeve sistematike të modeleve tradicionale. Produktet e reja pritet të publikohen gradualisht dhe mbështeten nga projekte kërkimore të programit Copernicus Marine Service Evolution. Integrimi i AI konsiderohet një hap i rëndësishëm drejt rritjes së efikasitetit, shpejtësisë dhe besueshmërisë së shërbimeve operationale për monitorimin e Tokës dhe oqeanëve.

AKTIVITETE NË VIJIM

AGILE 2026

Nga 16 – 19 qershor 2026, në Tartu, të Estonisë, do të zhvillohet Konferenca e 29-të e Shoqatës Evropiane të Laboratorëve të Informacionit Gjeografik, një ngjarje ndërkombëtare dedikuar informacionit gjeohapësinor. Konferenca fokusohet në “Smart Data”, duke theksuar shndërrimin e të dhënave gjeohapësinore në njohuri të përdorshme për vendimmarrje dhe zgjidhje problemesh reale, përmes kërkimeve dhe aplikimeve të reja.

16 - 19 Qershor 2026

www.asig.gov.al

FOSS4G Conference

Nga 29 qershor - 3 korrik 2026, në Timisoara, të Rumanisë, do të zhvillohet Konferenca Evropiane FOSS4G, dedikuar komunitetit të zhvilluesve, përdoruesve dhe mbështetësve të softuerëve me burim të hapur në fushën gjeohapësinore. Aktiviteti promovon përdorimin e teknologjive dhe të dhënave të hapura, duke nxitur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave në komunitet.

29 Qershor - 3 Korrik 2026

www.geoportal.asig.gov.al

ICERS Conference 2026

Nga 1 - 3 korrik 2026, në Zagreb, të Kroacisë, do të zhvillohet Konferenca ICERS 2026, një aktivitet ndërkombëtar i fokusuar në shkëmbimin e njohurive në fushën e Remote Sensing mjedisor dhe GIS-it. Konferenca do të mbledhë një komunitet global ekspertësh, akademikësh dhe profesionistësh për të prezantuar zhvillimet më të fundit dhe zgjidhjet e aplikuara në fushën gjeohapësinore.

1 - 3 Korrik 2026

E-mail: info@asig.gov.al